



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0439
Data e Vendimit: 07.07.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE LINDI MARKINGS SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV” me numër të prokurimit 616-22-11147-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 07/07/2023, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet si e jo e plotë, ankesa e LINDI MARKINGS SH.P.K. me Nr. të protokollit 2023/0439, e datës 29/06/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV”, me numër të prokurimit 616-22-11147-2-1-1, inicuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK).
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV”, me numër të prokurimit 616-22-11147-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të e-prokurimit me datë 29.06.2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE LINDI MARKINGS SH.P.K, për aktivitetin e prokurimit me “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV” me numër të prokurimit 616-22-11147-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së ngase lidhur me paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti, se Ankuesi, ankesës së lartcekur nuk i’a kishte bashkëngjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyrtarja për pranim të ankesave dhe protokollit përmes sistemit SML në të njëjtën date(29.06.2023 dhe 30.06.2023) ia kishte kthyer njëjtën Ankuesit për plotësim duke i sqaruar, se e njëjta duhet të ridërgohet e plotësuar me konfirmim të bankës për tarifën e ankesës në fjalë. njëhrit ishte njoftuar se nëse nuk vepron sipas udhëzimeve të OSHP ankesa e tij do të hedhet si e palejuar.

Duke u bazuar në faktin se [Ankuesi](#), nuk kishte ridërguar ankesën e tij OSHP edhe pse kishin kaluar disa ditë nga dërgimi për plotësim për hire të transparencës nëpërmjet emalit zyrtar te OSHP me, OSHP i drejtohet sërish Ankuesit me kërkesën që ankesa me nr. 439/2023 ta ridërgoj së bashku me konfirmimin e bankës si dëshmi te ankesës në fjalë, ne mënyrë që të plotësohet kushtet per procedim të mëtutjeshëm. OSHP, sqaron se deri me 07.07.2023, nuk e ka pranuar ankesën e plotësuar sipas kërkesës së institucionit, duke mos ofruar dëshmi-konfirmim nga banka për tarifën e ankesës në fjalë.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE LINDI MARKINGS SH.P.K e datës: 29.06.2023 (protokoll 439/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull me “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV” me numër të prokurimit 616-22-11147-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.lidhurparagrafin 2 të nenit 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

Autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet.

Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit megjithatë i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veprohet konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - LINDI MARKINGS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: